



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:136854

Datë: 09.01.2025

Numri i dokumentit: 06693504

P.nr.82/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A I nga fsh.B, K.P, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.587/2024 të datës 30.04.2024, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me dt.09.12.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala dhe i pandehuri A I me dt.09.12.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 09.01.2025, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

I pandehuri A I nga i ati Z I e ëma N I e gjinisë A, i lindur me datë , në fshatin B, K.P ku dhe jeton, me nr.personal , ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor Sigurimi, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pagjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:Me datë 15.04.2024 rreth orës 15:50 në rrugëkryqin P-P-Gj, në fshatin D K.K, pa autorizim posedon substancë narkotike të llojit“Marihuan”, në atë mënyrë që gjatë një pikë kontrolli të ushtruar nga policia, të njëjtit e ndalojnë automjetin e tipit Mercedes me targa 01-291-SC të cilën ishte duke e drejtuar i pandehuri e pasi policia e pyet të pandehurin se nëse posedonte me vete diqka ilegale , i njëjti deklaroi se me vete kishte një sasi të vogël të substancës narkotike të llojit marihuanë, ku pas analizës së Nar Test NT2000 ka rezultuar si pozitiv dhe është cilësuar si substancë narkotike e llojit Marihuanë në peshë neto 2.5 gram.

- me çka ka kryer veprë penale, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69,70 dhe nenit 269 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364, 449 dhe 463 të KPPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

I.Të pandehurit A I e dënon me Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale.

Në të kundërtën, nëse i pandehuri brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryen veprë tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 par.2 dhe 3 të KPRK-së, do ta revokon dënimin me kusht.

DËNIM ME GJOBË

II.Në shumën dyqind e pesëdhjetë (300) Euro, i cili dënim me gjobë do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Në rast se i pandehuri refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

.

DETYROHET: pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20 euro) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëzetë euro (20 euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

III.Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë me peshë neto 2.5 gram. Dhe të shkatërrohet.

A r s y e t i m

Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.587/2024 e datës 30.04.2024, kundër të pandehurit A I nga fsh.B K.P, për shkak të veprës penale; Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjykata me datë 09.12.2024, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala si dhe i pandehuri AI.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.09.12.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtarja e vetme gjykuese pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën , të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri A I ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

Deklarimi i palëve lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tij , pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe i ka propozuar gjykatës që të merr

parasysh intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe shkallën e përgjegjesisë penale.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja e vetme gjykuese ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale, të cilat mbështesin aktakuzën si: Shënim zyrtar i dt.15.04.2024, Raporti i Oficerit K B #11746 i dt.15.04.2024, Procerverbal i marrjes në pyetje të dyshuarin A I i dt.15.04.2024, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.15.04.2024, 3 (tri) foto.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Bazuar në të lartëcekurat gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në nenin 269 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen,, Kushdo që pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope ose analoge dënohet me gjobë dhe me burgim 1 (një) deri në tre (tre) vjet ,, ndërsa par.1 i nenit 269 të KPRK-së e për të cilin akuzohet i pandehuri parasheh se,, Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1 të këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se 3 tre gram të substancave narkotike ose substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 një vit,,

Andaj bazuar në të lartëcekura gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale,, posedimi i paautorizuar i narkotikëve , substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së, nga se veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësin e dënimit , me rastin e shqiptimit të dënimit të pandehurit bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së duke e vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese

Si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit , premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale .nuk do të Duke u bazuar në këto qe u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri nuk ka qenë i dënuar më parë, ashtu qe gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, sa i përket rrethanave rënduese gjykata gjeti dashjen.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Sipas bindjes së gjykatës, të pandehurit iu shqiptua dënimi kumulativ dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale dhe dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilën shumë obligohet i pandehuri që ta paguaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet u morë konform nenit 453 par.1 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 248 dhe nenit 365 dhe 370 të KPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.82/2024 me datë 09.01.2025

Bashkëpunëtorja Profesionale

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.